



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organ Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENTI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 543/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga Vedat Poterqoi- Kryetar, Kimete Gashi- referuese, Agon Ramadani- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik GOE "MEDPLUS SH.P.K. & KEIS (KOSOVA EX. IMP. SUPPLY PHARMACEUT) SH.P.K" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MJEKËSOR PËR NEVOJAT E QKMF-së, LOT 3", me nr. të prokurimit: 623-22-3932-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - "Kuvendi Komunal Rahovec, me datën 22.12.2022 mori këtë:

V E N D I M

I REFUZOHET si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik "GOE "MEDPLUS SH.P.K. & KEIS (KOSOVA EX. IMP. SUPPLY PHARMACEUT) SH.P.K" - Prishtinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 10.10.2022 me numër të protokollit 526/2022, për aktivitetin e prokurimit: "FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MJEKËSOR PËR NEVOJAT E QKMF-së, LOT 3", me nr. të prokurimit: 623-22-3932-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - "Kuvendi Komunal Rahovec.

II. Mbetet në fuqi Vendimi i AK për aktivitetin prokurimit LOT 3, të precizuar si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

III. Me qenë se ankesa e OE ankues, është refuzuar si e pa bazuar, konfiskohet depozita kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Me 27.09.2022, Autoriteti Kontraktues – KK Rahovec, ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MJEKËSOR PËR NEVOJAT E QKMF-së, LOT 3”, me nr. të prokurimit: 623-22-3932-1-2-1.

Me datën 03.10.2022, GOE “MEDPLUS SH.P.K. & KEIS (KOSOVA EX. IMP. SUPPLY PHARMACEUT) SH.P.K” - Prishtinë, ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar nga AK me vendim me datën 04.10.2022.

Me 14.10.2022 GOE “MEDPLUS SH.P.K. & KEIS (KOSOVA EX. IMP. SUPPLY PHARMACEUT) SH.P.K” - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me (Nr. protokoli: 543/22), kundër njoftimit për dhënies të cituar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, që në pajtim me nenin 113 të LPP ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 25.10.2022, duke i propozuar Panelit Shqyrtues që:

- Ankesa e OE të aprovohet si e bazuar;
- Të anulohet vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues

OE ankues në Ankesën me numër **P.SH. 543/22**, pretendon së gjatë udhëheqjes se këtij aktiviteti të prokurimit publik AK ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr. 04/L-042. i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, konkretisht nenet: **Neni 6, 7, 59 dhe nenin 60.**

Pretendimet ankimore, kanë të bëjnë me arsyetimin e OE ankues për refuzimin e pabazë të ofertës së tij dhe për refuzimin si të pabazuar të kërkesës për rishqyrtim, refuzim i cili ka ardhur pas kërkesës për sqarime të ofertës se GOE gjatë procesit të rivlerësimit të aktivitetit, konkretisht sqarimit të çmimeve të cilësuar si jo-normalisht të ulëta, në përputhje me nenin 61 të LPP-së.

Gjatë procesit të rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit, komisioni rivlerësues ka dërguar kërkesë për sqarime të çmimeve jo normalisht të ulëta, konkretisht për 8 pozicione nga 87 të tilla që janë

të paraqitura dhe që kërkohen për LOT-in 3 nga ana e AK, dokumenti: *"Lot III - Përshkrimi i Çmimeve - Furnizim me Barna Ampullare Emergjente material sanitar.xls"*

Në kërkesën për sqarim/arsyetim të çmimeve jo-normalisht të ulëta, GOE ankues ka dhënë sqarimet e veta për artikujt për çmimet njësi e të cilëve është kërkuar sqarim nga ana e AK-së, duke deklaruar në pjesën e fundme edhe gatishmërinë për rritjen e sigurimit të ekzekutimit në përputhje me **Nenin 30 të RRUOPP-së**.

Neni 30.4. Shuma e sigurimit të ekzekutimit do të jetë e barabartë me të paktën **10% të vlerës së kontratës**. Kur përcaktohet përqindja e sigurimit të ekzekutimit në rast të kontratave me vlerë të mesme ose të madhe. AK do të siguroj që përqindja mjafton për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata. Autoriteti kontraktues, pasi që të jetë përputhur me nenin 61 të LPP-se. ka mjaft arsye për të besuar se Operatori ekonomik e ka dorëzuar një tender të pa-zbatueshëm (jo-normalisht të ulët), gëzon të drejtën që përqindjen e kërkuar të sigurimit të ekzekutimit ta nis për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata.

Në bazë të kësaj AK do të kërkon nga OE të rekomanduar për dhënie të kontratës rritjen e sigurimit të ekzekutimit për 30% të vlerës së përgjithshme të kontratës. Edhe pse konstaton që në disa pozicione ka çmime Jo-normalisht të ulëta por në shumicën e pozicioneve ka çmimet e tregut. Dhe ta shpallte ofertën e GOE ankues si të përgjegjshme dhe kështu të shpërblente me kontratë për LOT 3, ofertën e përgjegjshme me çmimin me të ulët të peshuar/poentuar.

Eksperti shqyrtues i prokurimit mendon që nuk janë aplikuar si duhet nenet 6, 7, 59 dhe 60 të LPP-së, duke mos i marrë parasysh deklaratat dhe sqarimet e detajuara të dhëna nga GOE ankues, sqarime këto në përputhje me nenin 61 të LPP-së, konkretisht paragrafëve 1, 3 dhe 4.

Kërkesës për sqarime të AK-së, GOE ankues është përgjigjur dhe sqaruar ashtu siç parashihet me legjislacion përkatës si dhe në përputhje me tenderët kur çmimi përfundimtar është i përcaktuar me poentim, sqarime të cilat për komisioni vlerësues nuk kanë qenë bindëse mjaftueshëm, kurse për ekspertin shqyrtues po.

Prandaj, eksperti shqyrtues i prokurimit i rekomandon Panelit Shqyrtues të OSHP-së, që Ankesa të aprovohet **si e bazuar** dhe që aktiviteti i prokurimit të kthehet në **rivlerësim**.

Raporti i ekspertit shqyrtues është pranuar nga të dyja palët me ç'rast OE ankues pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues, ndërsa AK nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues pasi që shpjegon se tanimë kanë nënshkruar dhe filluar ekzekutimin e kontratës.

Konform nenit 24 par.1 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01./2020 Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritor të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë.

OE ankues pretendon se AK, me vendimin e datës 27.09.2022, ka bërë shkelje të rëndë të dispozitave të LPP, saktësisht të nenit 1, 7, 59 dhe nenin 61 të LPP, duke eliminuar Ankuesin nga ky aktivitet i prokurimit edhe përkundër faktit se ka ofertuar me çmim më të ulët në raport me OE tjerë. Në fakt, AK me datë 23.09.2022 (d.m.th. gjatë aktivitetit të prokurimit) ka kërkuar

sqarime shtesë nga OE ankues lidhur me çmimet e ofruara me ç'rast OE në rastin konkret, përmes platformes elektronike (e-prokurimi) ka ngarkuar një Deklaratë e cila AK-në nuk është e bindur.

Me rastin e vendosjes, AK nuk i ka marrë parasysh dokumentet e cituara si më sipër për shkak se Ankuesi nuk ka ofertuar me çmime të tregut, të njëjtat nuk janë reale dhe bindëse, ngase për një pjesë të pozicioneve ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta. Lidhur me këtë, nga shkresat e kësaj lënde mund të kuptohet se AK me rastin e hulumtimit përkitazi me çmimet e tregut për artikujt e njëjtë, ka konstatuar se nuk ka asnjë mundësi të gjenden artikuj me çmime të tilla, fare të pakrahasueshme me çmimet e artikujve të ngjashëm në treg, prandaj ka pasur të drejtë që ofertën e OE në rastin konkret ta konsideroj si jo të përgjegjshme.

Eksperti shqyrtues ka propozuar që lenda të kthehet në rivlerësim dhe ka shpjeguar se në rast se AK ka dyshime në mos furnizim mund të kërkojë rritjen e sigurimit të ekzekutimit sipas nenit 30.4 të RrUOPP. Mirëpo Paneli Shqyrtues konsideron se AK me kohë ka kërkuar shpjegime shtesë, gjatë rrjedhës së aktivitetit të prokurimit dhe se nuk është e arsyeshme që aktivitetit të prokurimit të kthehet sërish në rivlerësim, sepse nuk do ishte në harmoni me nenin 1, të këtij ligji qëllimi i të cilit është të sigurojë rrjedhën efikase të prokurimit dhe nenin 6, të Ligjit të cituar sipas të cilit fondet publike duhet të përdoren në mënyrën më ekonomike.

Sidoqoftë, Paneli Shqyrtues konsideron se në shkresat e kësaj lënde ka prova të mjaftueshme që vendimi meritator të merret edhe pa dëgjimin e palëve dhe njëherit konstaton se AK ka në harmoni me dispozitat e nenin 7, 59, 61 dhe 72 të LPP. Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Vlen të theksohet se për këtë aktivitet të prokurimit AK nuk ka vepruar konform nenit 109 të LPP-së, duke mos pritur mjaftueshëm kohën për paraqitjen e ankesës konform nenit të lartëcekur me ç'rast ka nënshkruar kontratën. Kjo do të kishte pasoja shumë të mëdha sikur ankesa do të ishte e bazuar dhe nga OSHP do të duhej të ndërmerre veprime të cilat do të sillnin shumë pasoja për palët kontraktuese.

Andaj, i bëhet vërejtje e fundit ZPP që OSHP do të kërkojë nga KRPP revokim të certifikatës në rast se nuk do të ketë kujdes në respektimin e dispozitave ligjore në fuqi për prokurim publik. Kjo nuk është hera e parë që OSHP bënë vërejtje ndaj ZPP.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Vedat POTERQOI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK RAHOVEC;

1x1 GOE "MEDPLUS SH.P.K. & KEIS (KOSOVA EX. IMP. SUPPLY PHARMACEUT) SH.P.K" - Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.